




KOLEGJI
PJETËR BUDI
PRISHTINË



KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

PROCESVERBALI I SENATITI

Prishtinë, 05.02.2026



Në përputhje me nenin 19 dhe 20 të Statutit të Kolegjit “Pjetër Budi” në Prishtinë

Procesverbal i vizitës monitoruese nga AKA-ja

1.	Data e takimit:	05/02/2026
2.	Ora:	16:30 – 17:30
3.	Vendi:	Kolegji “Pjetër Budi”- Prishtinë - Zyra e Rektorit
4.	Pjesëmarrës:	Prof.Ass.Dr. Sabri Klaiqi – Rektori i Kolegjit “Pjetër Budi” Prof.Ass. Dr. Luljeta Aliu – Prorektorja për mësim dhe hulumtim akademik, (online). Prof. Fiknete Bejta – Koordinatore e Zyrës së Cilësisë Prof. Valentina Vokshi / Sopjani Prof. Haqif Arifi Prof. Atdhetar Gara Prof. Gytene Syla Prof. Fitore Mehmeti Nil Qollaku – Kryetar i Parlamentit Studentor Gresa Syllejmani – Arkëtare e Parlamentit Studentor
M	Procesmbajtësi	Kryetar i Parlamentit Studentor
	Rendi i ditës	RENDI I DITËS: <ol style="list-style-type: none">1. Parapërgatitjet për fillimin e semestrit veror 2025/2026, diskutimi i ligjëratave, ushtrimeve, lëndëve, testeve (kollokuimeve), provimeve, orari, mungesat, etj.2. Informimi i fundit për transferin e mundshëm të studentëve në Kolegjin Pjetër Budi, afatet e maksimale/ligjore të transferit.3. Njoftimi i Senatit me përfaqësuesit e Parlamentit studentor.4. Të ndryshme.



Takimin e filloj Prof.Ass.Dr. Sabri Kllaqi, Rektori i Kolegjit "Pjetër Budi", Prishtinë, duke i përshëndetur të pranishmit dhe falënderuar për këtë takim obligativ shumë domethënëse sa i përket respektimit të Statutit të Kolegjit, që obligon rektorin së paku mbrenda vitit akademik të mbahen katër takime të Senatit.

PIKA E PARË:

1. Parapërgatitjet për fillimin e semestrit veror 2025/2026, diskutimi i ligjëratave, ushtrimeve, lëndëve, testeve (kollokuimeve), provimeve, orari, mungesat, etj.

Fillimisht Rektori e prezantoi rendin e ditë dhe e qiti në votim ku unanimisht u aprovua rendi i ditë me pikat e lartëcekura. Mandej Rektori edhe njëherë i falënderoi pjesëmarrësit, e sidomos kyesisë e re të Parlamentit Studentor, Kryetarin Nil Çollaku dhe Arkëtarin Gresa Sylejmani. Diskutimin Rektori e fokusoi në çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe lëndët dhe kurset në Kolegji, duke përfshirë: Politikën dhe procedurat për vlerësimin dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studentëve; Sigurimin e mësimin tërë jetësor; Standardet akademike dhe validitetin dhe rishikimin e lëndëve mësimore; Sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin; Zhvillimin e strategjisë për aktivitetet akademike në Kolegji dhe për mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato si dhe ofrimin e këshillave për rektorin dhe Bordin drejtues; Sigurimin e këshillave për çështje të tjera që Bordi Drejtues ose rektori mund të kërkojnë nga Senati etj. Senati u njoftua edhe me përbërjen e re të kryesisë së Parlamentit Studentor që ishin pjesëmarrës në takim.

Në vazhdim Rektori i njoftoi të pranishmit për përfundimin e semestrit dimëror dhe parapërgatitjet e fillimit të semestrit veror. Këtu Rektori i njoftoi pjesëmarrësit se semestri dimëror ka përfunduar sipas kalendarit akademik dhe ishte gjithçka në rregull, pa vërejtje dhe pa mungesa. Kurse sa i përket fillimit të semestrit veror Rektori i njoftoi të pranishmit se janë bërë të gjitha parapërgatitjet e domosdoshme që semestri të fillojë me 09.02.2026 dhe se ligjëratat me kërkesë të studentëve do të mbahen çdo dy javë nga ora 16:30. Në diskutim e tutje Rektori kërkoi që i gjithë stafi akademik, administrativ dhe Parlamenti Studentor të bëjnë maksimumin e duhur që procesi mësimor të zhvillohet sipas Planprogramit dhe syllabuseve që duhet prezantuar ditën/oren e parë të ligjëratave, këtu u pajtuan që të gjithë unanimisht dhe garantuan se janë në shërbim të Kolegjit dhe studentëve posaqërisht.



Në këtë pikë i diskutuan edhe çështje tjera siç ishin, kollokuimet, provimet, ushtrimet dhe secili nga ta dha ide dhe metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore, ku fajën e mori edhe Koordinatorja e cilësisë prof. Fiknete Bejta e cila kërkoj që testet/kollokuimet të hartohen gjithmonë sipas rregullores që KPB, pa e cenuar pavarësinë e profesorit në hartimin e kollokuimeve apo provimeve.

PIKA E DYTË

2. Informimi i fundit për transferin e mundshëm të studentëve në Kolegjin Pjetër Budi, afatet e maksimale/ligjore të transferit.

Në këtë pikë të rendit të ditë Rektori e njoftoj Senatin me afatit ligjore, procedurat dhe dokumentacion e kërkuar në lidhje me transferin e studentëve nga Universitetet dhe Kolegjet tjera në Kolegjin Pjetër Budi dhe anasjelltas, që në parin është fund i shkurtit. Këtu nuk pati diskutime të tjera veq se stafi dhe përfaqësuesit e Parlamentit studentor u treguan të gatshëm të ndihmojnë në këtë proces.

PIKA E TRETË

3. Njoftimi i Senatit me përfaqësuesit e Parlamentit studentor

Rektori me respekt, përshendetje dhe falënderime të veçanta para Senatit i prezantoi përfaqësuesit e ri të zgjedhur në fillim të vitit akademik me të drejta të barabarta për të kandiduar dhe me vota të feshefta dhe demokratike janë zgjedhur përfaqësuesit e ri të Parlamentit studentor me mandat dy vjeçar, me këtë përbërje. Nil Çollaku (viti dytë) - Kryetar i Parlamentit Studentor, Donita Shaqiri (viti parë), - Nënkyetare e Parlamentit Studentor dhe Gresa Sylejmani (viti tretë) - Arkëtare e Parlamentit Studentor.

Këtu fjalën e mori edhe Kryetari i Parlamentit Studentor dhe u prezantua personalisht para senatit dhe ofroj gadishmërin e tij maksimale për bashkëpunim me senatin stafin, administratën dhe mbi të gjitha me studentët që garantoj se do ti përfaqësoj dhe mbroj gjithmonë interesat e tyre.




PIKA E KATËRËT


4. Të ndryshme

Në këtë pikë u diskutuan edhe çshtjet e përgjithshme nga të gjithë të pranishmit edhe nga studentët ku vlenë të theksohet se Arkëtarja e Parlamentit Studentor falënderoj gjithë stafin akademik dhe Senatin për mundësinë e përfaqësimit dhe shprehjes së fjalës së lirë në interes të studentëve.

Në fund rektori i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe kontributin shumë të çmuar në avancimin e jetës akademike. Takimin e mbylli Rektori në ora 17:30


Procesmbajtësi:
Nil Çollaku




Rektori i Kolegjit "Pjetër Budi"
Prof. Ass. Dr. Sabri Klaiqi

Prishtinë, 09.02.2026